Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteiti i Arteve te Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Vizatimi II**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**1**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**6**
Përshkrimi i lëndës	Lënda Vizatim II përfaqëson vazhdimësinë dhe thellimin e koncepteve të fituara në Vizatim I, me fokus në analizën strukturore të formës, studimin e trupit njerëzor dhe zhvillimin e kompozimeve komplekse. Përmes punës me materiale tradicionale dhe eksplorimit të narracionit vizual (Flip Book), studentët avancojnë aftësitë e tyre analitike dhe kreative në ndërtimin e figurës, hapësirës dhe lëvizjes.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i lëndës është t'i ndihmojë studentët të avancojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në Vizatim I, duke zhvilluar analizën strukturore të formës, studimin e figurës njerëzore, perspektivën, kompozimin dhe paraqitjen e lëvizjes. Përmes teknikave tradicionale dhe eksperimentale, studentët zhvillojnë aftësitë analitike, krijuese dhe shprehjen individuale në vizatim.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: • Analizojë dhe ndërtojë formën përmes strukturës gjeometrike dhe anatomike. • Realizojë figura njerëzore në lëvizje dhe në hapësirë perspektive. • Zhvillojë kompozime figurative komplekse me balancë dhe thellësi. • Aplikojë teknika tradicionale dhe eksperimentale të vizatimit. • Krijojë një sekuencë vizuale (Flip Book), duke demonstruar kuptimin e lëvizjes. • Zhvillojë dhe prezantojë një projekt përfundimtar me koncept të qartë artistik.

Kontributi në ngarkesën e studentit **(gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	1	15	15

Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	3	5	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	6	12
Ushtrime në teren	2	2	4
Kollokfiume,seminare	3	4	12
Detyra të shtëpisë	3	6	18
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28
Përgaditja përfundimtare për provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet, etj	2	3	6
Totali			**150**
Metodologjia e mësimëdhënies:	Mësimdhënia realizohet përmes ligjëratave interaktive, demonstrimeve praktike, analizës vizuale dhe ushtrimeve të avancuara të vizatimit. Studentët zhvillojnë punë individuale dhe grupore, studime të figurës dhe hapësirës, eksperimente me teknika dhe materiale të ndryshme, si dhe projekte që ndërthurin vizatimin me narracionin vizual dhe lëvizjen. Procesi përfshin kritikën dhe analizën e punimeve, prezantimin e projekteve, konsultimet me mësimdhënësin dhe, kur është e mundur, vizita në galeri, muze dhe ekspozita.		
Metodat e vlerësimit:	60% Punime praktike gjatë semestrit 10% Flip Book 10% Prezantim dhe pjesëmarrje në kritikë 20% Projekt / Provim final **Shkalla e notimit (0–100 pikë)** • 0–49 pikë – Notë jo kaluese • 50–59 pikë – Nota 6 • 60–69 pikë – Nota 7 • 70–79 pikë – Nota 8 • 80–89 pikë – Nota 9 • 90–100 pikë – Nota 10		
Literatura			
Literatura bazë:	Classic Human Anatomy in Motion: The Artist's Guide to the Dynamics of Figure Drawing Aug 4, 2015 by Valerie L. Winslow		

Literatura shtesë:	Drawing Human AnatomyJun 26, 2018 by Giovanni Civardi
Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java I:	**Përpunimi i temave të Vizatim I** • *Përmbledhje e teknikave bazë: proporcionet, perspektiva, dritë-hija. Ndërtimi strukturor i formës.*
Java II:	**Linjat dhe ekspresioni** • *Krijimi i kompozicionit/figurës me anë të linjave ekspresive dhe dinamike*
Java III:	**Kompozicion - Natyrë e Qetë** • *Ndërtimi i kompozimeve më komplekse me fokus në balancë, hierarki dhe thellësi*
Java IV:	**Perspektiva lineare dhe atmosferike** • *Thellimi në perspektivën njëpikëshe dhe dypikëshe. Krijimi i thellësisë përmes tonit dhe gradacionit.*
Java V:	**Studimi i arkitekturës** • *Vizatimi i ndërtesave dhe strukturave komplekse.*
***Java VI*:**	**Vizatim i hapësirave të brendshme - enterieri** • *Vizatim i ambienteve të brendshme*
Java VII:	**Portreti në kënde të ndryshme** • *Teknikat e avancuara për vizatim të portretit në kënde të ndryshme*
Java VIII:	**Studimi i trupit njerëzor** • *Studimi i anatominë dhe detajeve të trupit njerëzor*
Java IX:	**Figura në lëvizje** • *Vizatimi i figurës në lëvizje*

Java X:	**Flip Book – Hyrje në lëvizje dhe animacion tradicional** • *Njohja me parimet bazë të animacionit. Planifikimi i një sekuence të thjeshtë me 20–40 vizatime.*
***Java XI*:**	**Realizimi i Flip Book** • *Zhvillimi i projektit individual. Analiza e vazhdimësisë, ritmit dhe koherencës së lëvizjes.*
***Java XII*:**	**Eksperimentim me teknika të ndryshme** • *Kombinimi i vizatimit me teknika të ndryshme (qymyr, pastel, tush, kolazh)*
***Java XIII*:**	**Abstraksioni dhe simplifikimi i formave** • *Krijimi i kompozimeve abstrakte dhe stilizimi i formave*
***Java XIV*:**	**Vizatim nga kujtesa dhe imagjinata** • *Krijimi i skenave dhe formave nga imagjinata*
***Java XV*:**	**Projekt përfundimtar dhe vlerësim** • *Finalizimi i projektit figurativ. Prezantim dhe analizë kritike*

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Pjesëmarrja e rregullt dhe angazhimi aktiv janë të detyrueshme. Studentët duhet të sjellin materialet e tyre, të jenë të përgatitur për punë dhe të respektojnë ambientin e klasës. Kritikat ndaj punimeve të kolegëve duhet të jenë konstruktive, duke respektuar përpjekjet e të gjithëve. Origjinaliteti dhe sjellja etike janë thelbësore, ndërsa përdorimi i pajisjeve elektronike lejohet vetëmP për qëllime mësimore.